Dt. 03.03.202

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr.2104/1 Prot. Tiranë, më 3.3.2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr.39 Datë 3.3.2022

PËR

ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "ALBCONTROL" SHA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, Urdhrit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 507/2, datë 15.10.2020 "Për kalim kapital të aktiveve afatgjata materiale nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti i Aviacionit Civil), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (Albcontrol sha)", Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve Nr. 80, datë 10.9.2021 "Për përgatitjen e dokumentacionit të zmadhimit ë kapitalit të shoqërisë "Albcontrol" sha Tiranë" dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Albcontrol "sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 10,276,000 lekë, i barabartë me 10.276 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila;

2. Kapitali themeltar i shoqërisë pas zmadhimit bëhet 5,963,417,000 lekë, i barabartë me 5,963,417 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila;

3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë;

4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Albcontrol" sha Tiranë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TIRANË

Nr. 2044 Prot
Dt. 20.12.21

Auditues Ligjor
Aida Maloku
Licensë Nr.55, datë 31.01.2000

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT TË REGJISTRUAR TË SHOQËRISË "ALBCONTROL" SHA, TIRANE

Drejtuar: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Shoqërisë "ALBCONTROL" sha

Në cilësinë e Audituesit ligjor, të caktuar me Shkresën nr. 13849/1, datë 10.09.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, jam caktuar për përgatitjen e raportit për sistemimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ALBCONTROL" sha për vlerën e aktiveve afatgjata sipas Urdhërit të përbashkët të MFE dhe MIE nr.5907/2, datë 15.10.2020 "Për kalim kapital të aktiveve afagjata materiale".

Baza ligjore për kryerjen e këtij misioni:

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar;
- Ligji nr.9723, datë 05.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar;
- Shkresa nr.13849/1, datë 10.09.2021, Vendim nr. 80, datë 10.09.2021 "Për përgatitjen e dokumentacionit të zmadhimit të kapitalit të shoqërise "ALBCONTROL" sha Tiranë, i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, përfaqësuar nga Ministri i MFE.

Përgjegjësia e Drejtimit të shoqërise "ALBCONTROL" sha, Tiranë është: Përgatitja dhe paraqitja e drejtë e deklarimeve financiare, juridike dhe informacioneve të tjera të domosdoshme për dhënien e sigurisë së procesit të vlerësimit të sistemimit të kapitalit të shoqërisë.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi sistemimin e kapitalit të shoqërisë "ALBCONTROL" sha Tiranë, zmadhim për vlerën e aktiveve afatgjata sipas Urdhërit të përbashkët të MFE dhe MIE nr.5907/2, datë 15.10.2020 "Për kalim kapital të aktiveve afagjata materiale". Opinioni do të bazohet në auditimin e pasqyrave financiare, lëvizjes së kapitaleve të veta, vendimeve të aksionerit mbi miratimin e pasqyrave financiare e cila është baza për ndryshimin e kapitalit.

Të dhëna të përgjithshme mbi shoqërinë:

Shoqëria "ALBCONTROL" sha është themeluar më 31.12.1998 si Shoqëri Anonime me kapital të regjistruar aktual në shumën 5.953.141.000 lekë të ndarë në 5.953.141 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secila. Kapitali zotërohet 100% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: "Shërbime të navigimit (lundrimit) ajror, të nevojshëm për të garantuar sigurinë, efiçencën dhe rregullshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjerë të publikuara në AIP Albania, në përputhje me standartet ndërkombëtare, marrëveshjet dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror të ratifikuara."
Adresa e zyrave qëndrore: Rinas, Tiranë.

Për sistemimin e kapitalit jemi referuar pasqyrave financiare të vitit 2020 të cilat janë të miratuara nga aksioneri si edhe pasqyrat financiare të ndërmjetme për vitin 2021. Zmadhimi i kapitalit të regjistruar do të kryhet per vlerën e aktiveve afatgjata sipas Urdhërit të përbashkët të MFE dhe MIE nr.5907/2, datë 15.10.2020. Lista e aam-ve paraqitet:

Emërtimi	Njesia	Sasia	Vlefte	Vlefte
Ndertesa e kulles				
Ndërtesa e kullës	copë	1		2,432,000
Nga e cila vlera e pajisjeve të tualetit është:				
Bolier	copë	1	8,190	
Lavaman porcelani	copë	1	5,040	
Tharëse duarsh	copë	1	10,080	
Pasqyrë	copë	1	4,410	
Wc allafrënga	copë	1	5,670	
Mbajtëse detergjentë larës	copë	1	1,260	
Mbajtëse letre higjenike	copë	1	1,260	
Ndricues të jashtëm të montuar në kullë	copë	3		9,450
Kullë hekuri për montimin e antenave	copë	1		514,080
Kondicioner qëndror i kullës	copë	1		63,000
Dhoma e bokseve elektrike				
Bokse elektrike CCR TAXIWAY 5KW	copë	1		50,400
Bokse elektrike CCR PAPI 5KW	copë	1		50,400
Bokse elektrike CCR RANWAY APROACH 15KW	copë	2		138,600
Filtër Kondicioneri Hokkaido	copë	1		12,600
Kasete elektrike	copë	2		37,800
Sistem alarmi kundra zjarrit	copë	1		20,160
Pult komande kondicioneri	copë	1		500
Dhoma e radiove				
Bokse RACK 1dhe RACK 2	copë	1		2,457,000
Panel qëndror elektrik	copë	1		94,500
lavaman inoksi me banak	copë	1		25,200
Bolier Ariston	copë	1		5,670
UPS tip (POWERWARE)	copë	2		151,200
Kondicioner Hokkaido	copë	1		22,680
Pult komande kondicioneri	copë	1		500

Pjesë rezerve				
Headset with PTT, Plantronics H101N Binaur	cope	2		8,820
Headset with PTT, Walker k-Style	cope	1		5,040
Hand Microphone With PTT Dynamict Holmt	cope	3		17,010
Paneli kontrollit	cope	1		567,000
Monitore 170A PHILIPS	cope	2		6,300
Tastiere	cope	2		1,260
Mouse	cope	2		760
Radio Position	cope	2		10,080
Telefon	cope	2		2,520
Kufje	cope	2		8,820
Mikrofon	cope	2		11,340
Tavolinë pune me ndricues për kontrollorin	cope	1		25,200
Karrige rrotulluese	cope	2		8,820
Filtër Hokkaido	cope	1		12,600
Pult komande kondicioneri	cope	1		500
Inventari i DVOR-it				
Kontinieri i DVOR-it	cope	1		151,200
Panel Interscan Navigation system DROR VR	cope	2		2,394,000
Interscan Navgation System DME LDB-102	cope	1		1,197,000
Oshiloskop tip LADER LS 8050	cope	1		13,860
Radio universal frekuenca cumter	cope	1		15,120
AC POWER SUPPLY	cope	2		163,800
Bateri L12 V42	cope	4		32,760
Bateri L6V110	cope	8		55,440
Kondicioner TECO	cope	2		45,360
Kompjuter me monitor ACER	cope	1		12,600
Tastier	cope	1		630
Mous	cope	1		380
Printer EPSON LX300+	cope	1		15,120
Vatmetër VICOM	cope	1		10,080
Telefon	cope	1		1,260
Tavolinë	cope	1		7,560
Antena me kokë të bardhë të montuara në DVOR	cope	48		1,572,480
Shtyllë me dy drita të kuqe orjentuese	cope	1		52,920
Shtylla metereologjike	cope	1		69,300
Shtylla me drita trengjyrëshe rrotulluese	cope	2		63,000
Shtylla me pajisje peër drejtimin dhe shpejtësine e erës	cope	2		63,000
Vlera totale				**12,708,680**

Me shkresën 9996/1, datë 07.06.2021 Vendim i asamblese së aksionerit nr.38, datë 07.06.2021mbi miratimin e vendimit të këshillit mbikqyrës të shoqërise "Albcontol" sha -Mbi shëmbjen e objektit kullë në aeroportin e Kukësit, aksioneri ka vendosur shëmbjen e objektit të vlerësuar në shumën 2.432.000 lekë e cila do të përjashtohet nga zmadhimi i kapitalit. Zmadhimi i kapitalit do të bëhet në shumën 10.276.000 lekë duke lënë në rezerva të tjera shumën 680 lekë për efekt të rrumbullakimit të

aksioneve. Këto asete janë të vlerësuara në zbatim të urdhrit nr.8700/1, datë 04.10.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale të Aeroportit të Kuksit", nga ekspertë persona fizikë dhe juridikë, të licencuar sipas dispozitave të posaçme, me kompetenca teknike të nevojshme për kryerjen e vlerësimeve.

Efektet e zmadhimit të kapitalit me aktivet afatgjata materiale në kontabilitet jane:

- Zmadhim i aktiveve afatgjata materiale në shumën 10.276.680 lekë,
- Zmadhim i kapitalit të regjistruar në shumën 10.276.000 lekë,
- Zmadhim i rezervave të tjera në shumën 680 lekë,

Kapitali i regjistruar i shoqërise "ALBCONTROL" sha Tiranë para këtij misioni është 5.953.141.000 lekë i ndarë në 5.953.141 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë secila, zotërues i të cilave është shteti shqiptar. Nga shoqëria morrën konfirmim se në këtë datë nuk kemi vendime të aksionerit të shoqërisë të padepozituara të cilat mund të ndryshojnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë zmadhohet në shumën 10.276.000 lekë.
Efekti i ndryshimeve të kapitalit të regjistruar është:

- **Kapitali i regjistruar para ndryshimit është 5.953.141.000 lekë**
- **Kapitali i regjistruar zmadhohet për 10.276.000 lekë**
- **Kapitali i regjistruar pas zmadhimit bëhet 5.963.417.000 lekë**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë "ALBCONTROL" sha, pas zmadhimit është 5.963.417.000 lekë (pesemiliard e nenteqindegjashtedhjetetremilion e katerqindeshtatembedhjetmijë lekë), i përbërë nga 5.963.417 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secila.

Ky kapital zotërohet 100% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sipas opinionit tonë sistemimi i kapitalit të regjistruar me aktive afatgjata materiale është kryer në përputhje me kuadrin ligjor, janë zbatuar të gjitha kërkesat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", i ndryshuar.

Ky raport mbahet në 3 (tre) kopje të njëjta.

Auditues Ligjor
Aida Maloku

Auditues Ligjor
Aida Maloku
NIPT: K32612411T
liç.nr. 55
ALBANIA

Tiranë më, 15.12.2021